REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 931/20
Datë/Datum. 30.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Zenel Hisenaj	*Data e autorizimit të ekspertit 18.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 30.11.2020*	Nr. i lëndës: 931/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.11.2020, **N.P.SH . " AFA-ING "; "K-ING" sh.p.k,** Suhareke ka parashtruar ankesë me nr: 937/20, kundër njoftimit për të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi me paisje teknologjike(Komjutera ,komplet,fotokopje ,kamera te sigurise ,printera,videoprojektore dhe paisje tjera**" me nr. të prokurimit: **624-20-5060-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SUHAREKË**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **30.000,00** €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – N.P.SH . " AFA-ING "; "K-ING" sh.p.k

Si pale me interes juridik e material sipas nenit 4.1.26 te LPP-se,brenda afatit ligjore te parapare ne nenin 108/A, parashtrojme kete kerkese per rishyrtim.
Me date: 29.10.2020, pranuam vendimin dhe letren standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilen ju keni dhene arsyetimin se ne nuk e permbushim kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. arsyetimi i dhene ne letren standarde eshte krejteisht i paqendrueshem, per faktin se te gjitha deshmit e ofruara jane ne perputhje te plote me kerkesat e DT-se dhe pretendimi juaj se nuk i permbushim kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional jane ne kundershtim me nenin 56.3 te LPP-se, sepse deshmit jane ne sipas kerkesave te

parapara ne kerkese te dosjes se tenderit nuk keni kerkuar qe ISO standardi te jet i ndonje fushe perkatese, konkretisht keni kerkuar qe OE te jet i certifikuar me ISO standard 9001:2015 dhe cdo tentativ e juaja per te dal nga kjo kerkese eshte ne kundershtim te hapur me paragrafin 3 te nenit 56 ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Gjate vleresimit te ofertave si autoritet kontraktues, ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se keni bere vlersimin e ofertes tone sepse "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Ne kuptim te nenit 59 te LPP-se, dhe pasi kemi analizuar arsyet e eliminimit konstatojm se eliminimi i ofertes tone nga ky aktivitet i prokurimit eshte ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se, sepse deshmit jane sipas kerkesave te dosjes se tenderit.
Sa i perket arsyetimit tuaj se nuk kemi ofruar deshmit lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike, kerkojme nga ju te verifikoni edhe nje here sepse deshmia lidhur me kete inxhinier gjendet ne oferten tone te dorezuar ne sistemin e eprokurimit. deshmit per kete inxhiner jane sipas kerkeses se dosjes se tenderit

Lidhur me katalogun, ku ju pretendoni se nuk eshte sipas paramases, ky pretendim nuk qendron sepse katalogjet e prodhuesve nuk shtypen sipas paramasave te autoriteteve kontraktuese. Vleresimi juaj per pajisjet eshte dashur te behet konform pajisjes te cilen e keni kerkuar dhe eventualisht per cdo paqartesi konform neni 39 te Rregullores dhe Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik, e cila ju mundeson qe ne harmoni me kete dispozite te kerkoni sqarim me te detajuar sa i perket katalogut dhe ISO standardit.

Përjashtimi automatik i një ofertuesi nga nje aktivitet i prokurimit eshte i sanksionuar sidomos ne rastet kur cmimi eshte me i lire qe dote thot se duhet te shfrytezohen te gjitha hapesirat qe i lejon ligji per sqarim te deshmive dhe duke u bazuar ne ate se ju nuk keni kerkuar kurrfar sqarimi rezulton qe nuk i keni respektuar dispozitat e nenit 60 te LPP-se dhe duke pas parasysh nenin 1, 6 dhe 7 te LPP-se si autoritet kontraktues ne harmoni me nenin 59 dhe 72 te LPP-se obligoheni qe te respektoni parimin e ekonomicitetit dhe trajtimin e barabarte te opratoreve ekonomik, me theks te vecant nenin 60 te LPP-se, Tenderi i pergjegjshem me cmim me te lire.

Prandaj, marrja e nje vendimi meritor nenkupton respektimin e plot te dispozitave te Ligjit per Prokurim Publik dhe nga ajo qe deklaruam me larte kerkojme qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lenda te kthehet ne rivleresim dhe per cdo eventualitet te kerkoni sqarime sepse deshmit e dorezuara jane ne perputhje te plote me kerkesat e dosjes se tenderit.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, nuk janë te njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Kërkesa1- Operatori ekonomik duhe ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Neni 65.

1. Dëshmia1- Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)

2. Kërkesa2 –Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës

2. Dëshmia2- Vërtetimi i ATK.

3. Kërkesa3-OE duhet ta siguroje AK se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë me nje dokuemtn te lëshuar nga Gjykata kompetente. Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

3. Dëshmia3- Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje)

4. Kërkesa4-OE duhet ta siguroje AK se ka kryer obligimet tatimore ndaj Komunes. Deshmia kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 90 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

4. Dëshmia4- Vërtetimi nga Komuna. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken 2,3 dhe 4, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Kërkesa1-Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo

1. Dëshmia1- Çertifikata e regjistrimit te biznesit, se bashku me dokumentin Informatë

regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje)	mbi Bizneset (kopje).
2. Kërkesa2-Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshire ne certifikaten e biznesit (kopje)	2. Dëshmia2- Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshire ne certifikatën e biznesit (kopje).
3. Kërkesa3- Çertifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje)	3. Dëshmia3- Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar::	
1. Kërkesa1- Operatori ekonomik duhet te ofrojë dëshmi të kënaqshëme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, ne tre vitet e fundit është jo më pak se 60,000.00 Euro.	1. Dëshmia1- Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore te dorëzuara ne ATK.
III.2.4) Përshtatshmëria profesionale:	
1. Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve,	1. Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj projekte te ngjashme ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit përkontrate ne vlerën prej se paku 45.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.
2. Kërkesa 2 Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushen perkatese, se paku	2. Dëshmia 2 Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, DHE dëshmitë e përfundimit Referenca t ose procesverbali et e pranimit teknik.
1.1. Një (1) Inxhinier te elektronikes a. se paku 3 vite përvoj pune pas diplomimit	Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV.

1.2. Një Inxhinier te Shkencave Kompjuterike a. se paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit	Dëshmia2 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinieret dhe stafin, Diplomat dhe e NOTERIZUARA dhe nga një CV.
3. Operatori duhe te ofroje katalogje për produktet, origjina e produkteve duhet të jetë nga vendet e BE-së.	Dëshmia3 – Katalogjet ose Broshurat, deshmi mbi origjinen e produktit
4. OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001 2015	Dëshmia 4- Çertifikata ISO 9001 2015
5. Kërkesa 5- OE duhet të ketë staf teknik, se paku 3 punëtor.	Dëshmia 5- Lista e punëtorëve, kontratat e punës ose para kontratë.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni pasi vlerësoi ofertat elektronike i rekomandon ZP-se qe te shpalle fitues OE CIMI@ ELECTRONIC SH.P.K me qmim me te lire ne vlere prej 23,799,00

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "OE NODE TECH"

Pretendimin Ankimor 1.

Si pale me interes juridik e material sipas nenit 4.1.26 te LPP-se,brenda afatit ligjore te parapare ne nenin 108/A, parashtrojme kete kerkese per rishyrtim.

Me date: 29.10.2020, pranuam vendimin dhe letren standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilen ju keni dhene arsyetimin se ne nuk e permbushim kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. arsyetimi i dhene ne letren standarde eshte krejteisht i paqendrueshem, per faktin se te gjitha deshmit e ofruara jane ne perputhje te plote me kerkesat e DT-se dhe pretendimi juaj se nuk i permbushim kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional jane ne kundershtim me nenin 56.3 te LPP-se, sepse deshmit jane ne sipas kerkesave te parapara ne kerkese te dosjes se tenderit nuk keni kerkuar qe ISO standardi te jet i ndonje fushe perkatese, konkretisht keni kerkuar qe OE te jet i certifikuar me ISO standard 9001:2015 dhe cdo tentativ e juaja per te dal nga kjo kerkese eshte ne kundershtim te hapur me paragrafin 3 te nenit 56 ku thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e

kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1.

Bazuar ne Ofertën e OE AFA-ING;"K-ING" shpk përkatësisht ISO Standard 9001:2015. OE ne fjale ka ofertuar me **ISO Standard 9001:2015, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave; Rrjete të ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimi i impianteve për trajtim të ujërave të zeza, rrugëve dhe urave.**

Ndërsa Projekti ne fjale ka te beje me Furnizim me Pajisje te TI-se, gjë qe një Standard i tille i ofruar nuk ka asnjë lidhshmëri me projektin, andaj konsideroi se ky ISO Standard i ofruar nuk plotëson kërkesat për këtë projekt.

Pretendimin Ankimor 2.

Sa i perket arsyetimit tuaj se nuk kemi ofruar deshmit lidhur me stafin, konkretisht me inxhinierin e shkencave kompjuterike, kerkojme nga ju te verifikoni edhe nje here sepse deshmia lidhur me kete inxhinier gjendet ne oferten tone te dorezuar ne sistemin e eprokurimit. deshmit per kete inxhiner jane sipas kerkeses se dosjes se tenderit

Përgjigje ne pretendimin Ankimor 2.

OE ne fjale rezulton se për këtë projekt ka ofruar stafin si ne vijim:

1. Ardian Morina – Diplome e ciklit te pare te Studimeve Universitare
   Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT

2. Bilbil Haxhijaha –Bachelor of science
   Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT

3. Florim Morina – Bachelor i shkencave te inxhinierisë elektrike
   Ne dosjen e ofruar nuk ka ndonjë dëshmi te jete Master apo ING ashtu siç kërkohet ne FDT

4. Izet Buzha – Inxhinjeri I diplomuar I Elektronikes

5. Florian Mucolli- bazuar ne CV e te njëjtit dhe dokumenteve përcjellëse rezulton se:
   a. Posedon diplome Bachelor ne drejtimin: Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
   b. November 2012 (Working on Master Thesis) – nuk ka dëshmi se ka te përfunduar Master

   Konsideroi se ne lidhje me këtë AK do duhej conform nenit 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese për dëshmitë e te njëjtit pasi ne dosjen e ofruar nuk ka Diplome Master, mirëpo ne CV ceket: November 2012 (Working on Master Thesis).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Suharekë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - OE N.T.SH "Node Tech"